

AKT THEMELIMI DHE STATUT

"ALBALKA GROUP" SH.P.K.

Në këtë Akt Themelimi dhe Statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Akt Themelimi Statuti" është Akt themelimi dhe Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, me datë 22/06/2022, Unë themeluesja Jetmira Divitku kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: "**ALBALKA GROUP**" SH.P.K.


(2) Themeluese e shoqërisë është : **Znj. JETMIRA DIVITKU**, me atësi Xhavit dhe amësi Lirije, e datëlindjes 24.02.1984, lindur dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e pasaportës me numër BA5302791 dhe ID numër personal I45224023B me zotësi të plotë juridike, me adresë Rruga "Vllazën Huta", Nd. Nr. 90, H.1, Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë; dhe adresë personale elektronike: jetmiradivitku@gmail.com dhe numra kontakti personal: 00355682064294 dhe 00355692241762

Objekti

Shoqëria "**ALBALKA GROUP**" SH.P.K do të kryejë shërbimet si vijojnë:


Agjensi turistike me profil të gjerë dhe pa limitim për shtetas shqiptarë dhe të huaj (incoming dhe outgoing) do të merret me: Organizim udhëtimesh individuale ose në grupe për shtetas të huaj dhe shqiptarë brenda dhe jashtë vendit; Promovimi i turizmit në Shqipëri dhe jashtë saj; Shitje biletash, dhe jo vetëm po edhe organizime turesh turistike brenda dhe jashtë vendit; Organizmi transporti turistik tokësor, me guidë shoqëruese dhe jo vetëm, transport detar, ajror, agroturizëm, trajnime, kurse të ndryshme dhe kualifikime në fushën e turizmit. Organizimi i eventeve në fushën e turizmit dhe përhithjes së turistëve të ndryshëm; Organizimi i seminareve trajnuese dhe informuese për guida dhe/ose operatorë të ndryshëm turistikë të huaj apo shqiptarë; si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me realizimin e këtij objekti, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi; etj.;

Agjensi ndërkombëtare punësimi, konsulence dhe formimi profesional: Ofrime të kontratave të punës për punëkërkuar shqiptar dhe të huaj për llogari të kompanive



shqiptare dhe të huaja si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj; Ofrim i stafit teknik shqiptar dhe të huaj, të kualifikuar sipas kërkesave të tregut për llogari të të tretëve; shërbim përlogaritjeje pagash dhe rekrutim për të tretët; Ofrim i shërbimit të asistencës teknike për aplikimet për leje punë dhe leje qëndrimi për të huajt; Ofrim i shërbimit të asistencës teknike për aplikimet për leje punë dhe leje qëndrimi për shtetas shqiptarë që marrin kontrata pune jashtë vendit; Ofrim i akomodit të stafit shqiptar dhe të huaj për llogari të të tretëve; Organizim i trajnimeve të ndryshme profesional si dhe organizime të praktikave profesionale dhe mësimore me qëllim trajnimin e stafit shqiptar dhe të huaj për llogari të të tretëve; Asistence të përhershme për klientët e saj në plotësimin e dokumentacionit dhe riaplikimet për kontrata pune, leje pune, leje qëndrimi dhe çdo aplikim të kërkuar pranë institucioneve për shtetasit e huaj për qëllime pune në Republikën e Shqipërisë si dhe konsulencë dhe aplikim për viza turistike, leje qëndrimi, leje punësimi, regjistrim në institucione arsimore për familjarët e klientëve tanë të huaj që punësohen në Shqipëri; Asistence të përhershme për klientët e saj në plotësimin e dokumentacionit dhe riaplikimet për kontrata pune, leje pune, leje qëndrimi dhe çdo aplikim të kërkuar pranë institucioneve për shtetasit shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe konsulencë dhe aplikim për viza turistike, leje qëndrimi, leje punësimi, regjistrim në institucione arsimore për familjarët e klientëve tanë shqiptarë që punësohen jashtë Shqipërisë; Aplikime për vizë pune në Përfaqësitë Diplomatike të huaja (Ambasadat) që operojnë në Shqipëri për shtetas shqiptarë që përfitojnë kontratat e punës jashtë vendit; si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me këtë objekt, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi etj.;

Agjensi Imobiliare: Ndërmjetësim në shitblerje dhe dhënie me qira pronash të paluajtshme për banim apo zhvillim të bizneseve të ndryshme për klientë të huaj dhe shqiptarë; Studime tregu për pasuri të paluajtshme për individë, familje dhe biznese të huaja dhe shqiptare; Komisioner dhe agjenci për te trete; Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme; çdo aktivitet tregtar, financiar, qira/leasing, hipotekim ose penglënie për llogari të klientëve individë dhe kompani të huaja dhe shqiptare; Konsulenca të ndryshme dhe asistencë lidhur me pronat, për shitjen, blerjen, dhënien apo marrjen me qira si dhe rivlerësimin e tyre, në Shqipëri apo jashtë saj për klientë të huaj apo shqiptarë; Menaxhim pronash, menaxhim të qirave, menaxhim të ambjenteve të biznesit për llogari të të tretëve; menaxhim të shtëpive apo apatamente me qera ditore për llogari të kompanisë apo për llogari të të tretëve; Arredime të brendshme shtëpie dhe arredime për biznese të ndryshme; Konsulencë tregtare dhe investimi, Plane Biznesi, Plane Marketingu apo shërbime të tjera të ngjashme për kompani të huaja dhe shqiptare në zhvillimin e pronave të paluajtshme; Çdo shërbim tjetër në lidhje me tregun imobiliar në të gjitha nivelet e shërbimit për klientë të huaj dhe shqiptarë duke ofruar asistencë në përfaqësimin e tyre në plotësimin e dokumentacionit dhe kryerjen e të gjithë procedurave pranë institucioneve të ndryshme; Operacione tregtare në komisioneri; Mund të marre pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë veprimtari të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me veprimtarinë e saj përmes një marrëveshjeje franchising; Zhvillimi dhe operimi i zyrave të ndërmjetësimit për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të veçantë Franchising; Nënlicensimin franshizmarësve nëpërmjet dhënies së autorizimit për përdorimin e



markës së shoqërisë dhe gjithë sistemit që përbëhet nga plane, mjete marketingu, procedura dhe teknika të administrimit të zyrave etj. në përputhje me kushtet e parashikuara në marrëveshjen në kuadër të "franchising" për kompani të huaja dhe shqiptare; Asistencë në administrimin e pronave të paluajtshme (banim apo biznes) për shitje ose dhënie me qera për llogari të klientëve të huaj (individë/biznese); Trajtime dhe konsulenca në trajtimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme; Si dhe çdo veprimtari që veçmas ose sëbashku me ato të përmendura më sipër do të konsiderohet e përshtatshme dhe me leverdi për rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi etj.;

Agjensi konsulence biznesi dhe biznes set up: duke përfshirë inkorporim dhe regjistrim të kompanive për individë dhe kompani të ndryshme të huaja dhe shqiptare; regjistrimin e degëve/filialeve dhe përfaqësive të kompanive të huaja në Republikën e Shqipërisë; regjistrimin e degëve/filialeve dhe përfaqësive të kompanive shqiptare jashtë territorit shqiptar; aplikimi për regjistrimin e kompanisë pranë institucioneve përkatëse shqiptare për klientë të huaj dhe shqiptarë; regjistrim marke; regjistrim agjensie; sigurimi i kontakteve dhe lidhjeve të biznesit me kompani të huaja dhe shqiptare; aplikim për leje qëndrimi dhe vizë pune për klientë të huaj; aplikim për leje qëndrimi dhe vizë pune për stafin e kompanive; shërbime për mbështetje zyre dhe biznesi; shërbimet e emërimit; shërbimet e administrimit të besuar; shërbimet e transferimit të aksioneve; shërbime sekretarie; sigurimi i adresës së regjistrimit të biznesit; shërbime përkthimi për klientë të huaj dhe shqiptarë; këshillim ligjor në praktika kontraktuale dhe administrative të ndërlidhura me kompani të tjera shqiptare dhe të huaja, me administratën shtetërore shqiptare, projekte, etj.; ofrimi i konsulencës për bizneset, strategjike dhe menaxheriale në të gjitha format dhe sektorët e saj për klientë të huaj dhe shqiptarë; ofrimi i shërbimeve që lidhen me sferën e menaxhimit, që kanë të bëjnë veçanërisht me organizimin e shoqërive, trajnimin e personelit, financat dhe kontrollin e administrimit, si dhe zhvillimi i planeve të biznesit e në përgjithësi çdo mundësi zhvillimi për investimet e reja; mbledhja e të dhënave, të saj apo të të tretëve, përpunimin e tyre, organizimin e sistemeve të kontabilitetit në formën tradicionale dhe elektronike për llogari të kompanive, të tregtarëve ose të privatëve, kontrolli teknik i shoqërive si dhe aktivitet tjetër i ngjashëm me to; ofrimin e shërbimit të asistencës së klientëve në studimin e tregut për fushën e interesit të tyre, në hartimin e planeve të biznesit dhe implementimin e tyre për kompani të huaja dhe shqiptare si dhe përpunimi i të dhënave për llogari të vet ose për palët e treta; si dhe çdo veprimtari tjetër që nevojitet në ofrimin e shërbimit të konsulencës për biznese të huaja dhe shqiptare në përputhje me Legjislacionin shqiptar;

Agjensi Marketingu, Promocioni dhe Digital Marketing: Studimin, projektimin, zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve marketing, promocione, web marketing, informacione, hulumtime të tregut dhe përpunimin e të dhënave; konceptimin, projektimin, krijimin dhe administrimin e faqeve dhe portaleve; hartimi, zbatimi dhe menaxhimi në emër të palëve të treta për shërbimet ecommerce në internet dhe për publikimet elektronike në përgjithësi; studimi, hartimi dhe realizimi i reklamave dhe fushatave publicitare në përgjithësi, si për kompaninë dhe për të gjithë ata që janë pjesë e saj, si dhe me kërkesë të individëve, të bizneseve, enteve apo të subjekteve të tjera

në përgjithësi edhe jo ortake, që do të kryhen pa kufizim mjetesh dhe/ose mënyrash, me përjashtim të atyre të përcaktuara nga "Autoriteti"; të kryejë aktivitete të ndërmjetësimit në përgjithësi për klientë të huaj dhe shqiptarë, gjithashtu edhe aktivitete ndërmjetësimi midis kompanive të huaja, shqiptare apo palëve të treta; mund të kryejë të gjitha aktivitetet që synojnë komercializimin e shërbimeve dhe produkteve të përfshira në objektin e shoqërisë, si dhe duke dhënë, për këtë qëllim, të drejta agjensie dhe përfaqësimi; mund t'ia delegojë agjensive apo subjekteve të regjistruar në shoqëri, komisionet, përfaqësimet, me ose pa depozitë, dhe të drejtën për të blerë, të shitur, të përdori dhe transferojë patenta, teknologji dhe know-how, si dhe të gjithë shërbimet e përfshira në objektin e veprimtarisë, përmbushja dhe promovimi i hulumtimit të tregut dhe përpunimi i të dhënave për llogari të vet ose për palët e treta, të japë dhe të marrë licencat e shfrytëzimit komercial si dhe të kryejë të gjitha operacionet tregtare (përfshirë këtu edhe import - eksport), financiare, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, të nevojshme dhe /ose të dobishme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë; mund të kryejë veprimtari agjencie dhe përfaqësimi; mund edhe të përmbushë, në rrugë instrumentale të gjitha aktivitetet e nevojshme, të dobishme ose të mundshme për arritjen e objektit të veprimtarisë, sidoqoftë duke respektuar plotësisht normat e ligjit dhe mund të marrë si drejtpërdrejt ashtu dhe jo drejtpërdrejt, në Shqipëri ose jashtë saj, pjesëmarrje në shoqëri me qëllime të ngjashme, analoge e plotësuese, të marri pjesë në konsorciume, grupime apo bashkime të përkohshme të shoqërive; mund të lidhë marrëveshje me kompani të tjera të huaja ose shqiptare, shoqata, institucione publike ose individë në përgjithësi, të cilat shërbejnë për arritjen e qëllimeve të biznesit; Agjensia, për arritjen e qëllimeve të saj, mund të përmbushë çdo veprimtari tregtare, të ndërmarrë veprimtari me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, të blejë dhe shesë kompani, të lidhë kontrata qiraje, në cilësinë e qiradhënësit ose të qiramarrësit, të blejë dhe shesë marka tregtare, patenta dhe shenjat, të lidhë kontrata Leasing, dhe gjithashtu të kryjë çdo aktivitet të lejueshëm për publikum, transaksionet financiare dhe letrat me vlerë, të japë garancitë, duke përfshirë lëshimin e garancive reale e personale, edhe në favor të të tretëve si dhënëse hipoteke. Shërbime dhe dhënie ambjentesh me nënqira për kompani të huaja dhe shqiptare; Organizime brenda dhe jashtë Shqipërisë të panaireve, eventeve, seminareve, trajnimeve, workshops, konferencave, etj. për llogari të institucioneve shtetërore, kompanive private shqiptare dhe të huaja, individëve etj.;


Agjensi import-eksport dhe tregëti me shumicë dhe pakicë: Tregëti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm si edhe importimin dhe eksportimin e tyre; Import eksport të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore e blegtorale dhe nënprodukte të tyre; fruta – perime; pije të ndryshme, pajise elektronike, hidraulike dhe elektrike, pjesë këmbimi, vegla pune, etj. tregtimin e tyre me shumicë e pakicë si dhe transport mallrash dhe udhëtarësh; Bashkëpunime tregtare për llogari të kompanive të huaja dhe shqiptare; Përfaqësi/degë/filiale të kompanive të huaja në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj; Përfaqësi/degë/filiale të kompanive shqiptare si brenda dhe jashtë Shqipërisë; Import - eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të: artikujve ushqimore, nënprodukte dhe përbërës të tyre dhe pijeve të ndryshme; Tregëtim të mallërave, materialeve, automjeteve, mjeteve industriale; makinerive, pajisjeve dhe impjanteve të ndryshme të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregëtar, kulturor, sportiv, shërbimeve; Marrëveshje tregtare për llogari të të tretëve mes

kompanive të huaja dhe shqiptare; krijimin e rrjeteve të supermarketeve, dyqaneve, zyrave të përfaqësimit për llogaritë të saj dhe të të tremeve si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; etj.;

Agjensi Konsulence Ligjore Ndërkombëtare: duke përfshirë asistencë ligjore për kompani të ndryshme të huaja dhe shqiptare të regjistruara dhe që zhvillojnë aktivitetin e biznesit në Republikën e Shqipërisë; asistencë ligjore për degët/filialet dhe përfaqësitë e kompanive të huaja që ushtrojnë veprimtarinë e biznesit në Republikën e Shqipërisë; asistencë ligjore për degët/filialet dhe përfaqësitë e kompanive shqiptare që ushtrojnë veprimtarinë e biznesit jashtë territorit shqiptar; asistencë ligjore permanente të kompanive pranë institucioneve të administratës publike shqiptare për klientë të huaj dhe shqiptarë; asistencë ligjore në lidhjen e kontratave të reja si dhe ndërmjetësi në krijimin e kontakteve të reja të biznesit me kompani të huaja dhe shqiptare; asistencë ligjore për përfaqësimin e kompanive të huaj dhe shqiptarë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Institucionet shtetërore dhe palëve të treta pranë Gjykatave të të gjitha shkallëve si brenda dhe jashtë territorit shqiptar; asistencë ligjore në përfaqësimin e kompanive të huaja dhe shqiptare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pranë Institucioneve shqiptare të të gjitha niveleve; asistencë ligjore në përfaqësimin e kompanive të huaja dhe shqiptare në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palë të treta si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë; ofrimi i konsulencës ligjore për bizneset strategjike dhe menaxheriale në të gjitha format dhe sektorët e saj për klientë të huaj dhe shqiptarë me fushë veprimi të biznesit si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; asistencë ligjore për përfaqësimin e individëve të huaj dhe shqiptarë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Institucionet shtetërore dhe palëve të treta pranë Gjykatave të të gjitha shkallëve si brenda dhe jashtë territorit shqiptar; si dhe çdo veprimtari tjetër që nevojitet në ofrimin e shërbimit të konsulencës ligjore për individë të huaj dhe shqiptarë, si dhe biznese të huaja dhe shqiptare në përpunje me Legjislacionin shqiptar; etj;

Agjensi Argëtimi: konsiston në krijimin e bizneseve me karakter argëtues brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë: ambiente argëtimi të dedikuara për fëmijët e të gjitha moshave, ambiente çlodhëse dhe argëtimi për moshë të ndryshme, ambiente me karakter: sportiv, edukativ, kulturor dhe argëtues për të gjitha moshat; organizimin e aktiviteteve të ndryshme argëtuese për target grupe të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë; bashkëpunime me kompani të huaja dhe shqiptare në krijimin e bizneseve në bashkëpunësi dhe/ose përfaqësimin e degëve/filialeve të kompanive të huaja dhe shqiptare si brenda ashtu edhe jashtë territorit shqiptar; hapjen e bareve, restoranteve, food & beverage, shërbimin delivery, shërbimin catering, hotele, resorte, ambiente kampingu, shtëpi pushimi, etj. ku në fokus është argëtimi qoftë brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë; si dhe çdo veprimtari që veçmas ose sëbashku me ato të përmendura më sipër do të konsiderohet e përshtatshme dhe me leverdi për rritjen dhe zhvillimin e Agjencisë së Argëtimit në përpunje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Agjensi Ndërkombëtare Konsulence, Rekrutimi për Edukimin dhe Promovimin e Arsimit: Ofron për shtetas të huaj dhe shqiptarë: konsulencë, rekrutim dhe shërbime



asistence me fokusin e arsimit duke filluar me studimet e ndryshme që në nivelin e parashkollorëve, të nxënësve nga fillorja deri në përfundimin e shkollës së mesme dhe/ose kolegjit, studentëve për studimet universitare dhe pasuniversitare, si dhe klientëve të interesuar në formime të ndryshme profesionale, pranë Institucioneve Arsimore Publike dhe Private si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Ofron asistencë për klientë të huaj që kanë dëshirë për të studiuar pranë Universiteve Shqiptare Publike dhe Private duke përfshirë dhënie informacioni për regjistrimin, tarifat e studimit, programet e studimit, dokumentat e udhëtimit, informacion për vizat studentore, akomodim, leje qëndrimi, bursat, intershipet, oportunitete punësimi, etj; Ofron asistencë për klientë shqiptarë që kanë dëshirë për të studiuar pranë Universiteve Ndërkombëtare Publike dhe Private duke përfshirë dhënie informacioni për regjistrimin, tarifat e studimit, programet e studimit, dokumentat e udhëtimit, informacion për vizat studentore, akomodim, leje qëndrimi, bursat, intershipet, oportunitete punësimi, etj; Ofron asistencë për klientë të huaj dhe shqiptarë të profilit akademik duke përfshirë: edukatorë kopshti, mësues, profesorë, trajnues, etj. që kanë dëshirë për të thelluar studimet pranë Institucioneve Arsimore Ndërkombëtare dhe Shqiptare, duke përfshirë dhënie informacioni për regjistrimin, tarifat e studimit, programet e studimit, dokumentat e udhëtimit, informacion për vizat, akomodim, leje qëndrimi, bursat, intershipet, oportunitete punësimi; etj, Ofron kontrata pune për klientë të huaj dhe shqiptarë të profilit akademik duke përfshirë: edukatorë kopshti, mësues, profesorë, trajnues, etj. që kanë dëshirë për të punuar pranë Institucioneve Arsimore Ndërkombëtare dhe Shqiptare duke përfshirë dhënie informacioni për kontratën e punës, intervistat me punëdhënësin, dokumentat e udhëtimit, informacion për vizat, akomodim, leje qëndrimi për klientin por edhe për familjarët e tij në rast se kërkohet, etj.; Promovimin, krijimin ose akreditimin e instituteve model për certifikimin e njohurive: të përdorimit të kompjuterit, të gjuhëve të huaja, dhe aftësive të veçanta profesionale sipas standardeve më të njohura ndërkombëtare; Promovimin dhe reklamimin e çertifikimit të personelit nëpërmjet pjesëmarrjes në programe, konferenca, panaire, si dhe nëpërmjet publikimit dhe tregimit të literaturës së specializuar; Konsulencë për ndërtimin e programeve arsimore që synojnë kualifikime profesionale për personelin si edhe çertifikimin e tyre; Veprimtari trajnuese dhe çertifikuese të: punonjësve të administratës publike, punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore publike dhe private, individëve, etj.; Ofron bashkëpunimin në përfaqësimin / degë / filiale të huaja arsimore në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj; Ofron ndërmjetësimin midis Institucioneve Arsimore Ndërkombëtare Publike dhe Private me Institucione Arsimore Shqiptare Publike dhe Private për llogari të vet ose të tretëve (personave fizik dhe/ose juridik shqiptar ose të huaj); Promovimin e Institucioneve të Arsimit Publik dhe Privat si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Organizime brenda dhe jashtë Shqipërisë të panaireve, eventeve, seminareve, trajnimeve, workshops, konferencave, etj. për llogari të Institucioneve Shtetërore, kompanive private shqiptare dhe të huaja, etj.; Si dhe çdo veprimtari tjetër në fushën e arsimit dhe promovimit të arsimit, që është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Agjensi Konsulencë mbi teknologjinë e Informacionit

Agjensi për zhvillimin e produkteve të teknologjisë së Informacionit

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti lidhur me objektin e saj, të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat dhe dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4:

Selia

- 1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Vllazën Huta", Nd. Nr. 88, Nr.1, Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë.
- 2) Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, shoqëria mund të hapë filiale, degë dhe zyra përfaqësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.
- 3) Adresa elektronike e shoqërisë për qëllim të komunikimeve elektronike është info@albalka.com dhe website zyrtar i kompanisë është www.albalka.com.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100'000 (një qind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e saj si më poshtë vijon:

1. Ortaku themelues Jetmira Divitku zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100'000 (një qind mijë) Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para/monedhë të huaj dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; si edhe hapjen dhe regjistrimin e filialeve, degëve dhe/ose zyra të përfaqësimit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe/ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- b) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas shkronjës "a" të këtij neni për arsye urgjente dhe/ose të jashtëzakonshme në lidhje me vendimmarrje të emergjente për shoqërinë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht mënyrës jo të zakonshme të mënyrës së thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të përcaktuar në shkronjës "a" të këtij neni.
- c) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvillohet dhe online nëpërmjet internetit dhe vendimet dhe aktet e tjera nënshkruhen në mënyrë elektronike.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas Nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet (pesë vjet) nga data 22.06.2022, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratori i shoqërisë tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i Parë i Shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit të Administratorit:

Znj. JETMIRA DIVITKU, me atësi Xhavit dhe amësi Lirije, e datëlindjes 24.02.1984, lindur dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e pasaportës me numër BA5302791 dhe ID numër personal I45224023B me zotësi të plotë juridike, me adresë Rruga "Vllazën Huta", Nd. Nr. 90, H.1, Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë; dhe adresë elektronike: jetmiradivitku@gmail.com dhe numra kontakti personal: 00355682064294 dhe 00355692241762

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

- 1) Administratori ka të drejtë e detyrohet:



- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2) Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- 1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
- 2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- 3. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator për shoqërinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ata e administrojnë sëbashku shoqërinë.

Në rastet e regjistrimit të filialeve, degëve dhe/ose zyra të përfaqësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, administratorët e administrojnë shoqërinë për territorin e shtetit në të cilin janë emëruar si administratorë.

4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare duke vlerësuar shkallën e dëmit/dëmeve dhe pasojës/pasojave.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesës padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar - Ekspertët

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja – Riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të Gjykatës;

Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Degët dhe zyrat e përfaqësimit

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të krijojë dhe regjistrojë degët/filiale dhe zyrat e saj të përfaqësimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Gjuha e përdorur

Gjuha e përdorur në Akt themelimin dhe Statutin e shoqërisë u hartuar në gjuhën Shqipe.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


TIRANË, MË 22/06/2022

ORTAKJA E VETME

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ALBALKAL GROUP" SHPK

JETMIRA DIVITKU

A handwritten signature in blue ink, reading "Jetmira Divitku". Below the name is a stylized, abstract scribble or flourish.